



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

---

## **Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit**

Programi i studimit:

**EDUKIMI NË FËMIJËRI TË HERSHME (0-6 vjet)**

*Niveli i studimeve:*

Bachelor

*Numri i kredive:*

240 ECTS

*Akredituar për periudhën:*

1 Tetor 2024 - 30 Shtator 2027

# 1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit BA Edukimin në fëmijërinë e hershme është në përputhje të plotë me misionin e Fakultetit të Edukimit. Qëllimi kryesor i programit është përgatitja e edukatorëve të ardhshëm të cilët do të jenë kompetentë në punën profesionale në fëmijëri të hershme. Ky program synon që edukatorët e ardhshëm të zotërojnë anën teorike të fushës së tyre profesionale, të zbatojnë teorinë në praktikë, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të zhvillojnë aftësi praktike për të ndihmuar fëmijën në zhvillimin e tyre tërësor përfshirë atë fizik, social, emocional, njohës dhe të personalitetit. Kompetencat e edukatorëve të ardhshëm synojnë të arrihen nëpërmjet programit katërvjeçar, i cili përfshin aspekte nga fusha e psikologjisë dhe pedagogjisë së fëmijërisë së hershme, pedagogjisë lëndore/ akademike dhe praktikës pedagogjike të organizuara në institucione parashkollore dhe shkolla. Gjatë periudhës katër vjeçare studentët do të përfshihen gjithashtu në aktivitete ekstrakurrikulare, si dhe kërkime të ndryshme që do t'i ndihmojnë ata të marrin vendime bazuar në dëshmi.

Misioni i programit Bachelor Edukimi në Fëmijëri të Hershme është në përputhje me deklaratën e përgjithshme të misionit të Fakultetit të Edukimit dhe me politikat arsimore në nivel vendi. Misioni i programit është të sigurojë një program cilësor për përgatitjen dhe trajnimin e vazhdueshëm të edukatorëve, të cilët do të jenë kompetentë në punën profesionale me fëmijët në fëmijërinë e hershme.

## 2. REZULTATET E PRITURA TË PROGRAMIT

Rezultatet e pritura të programit i shërbejnë realizimit të qëllimit të programit, Këto rezultate janë të shkruara nga perspektiva e studentit dhe tregojnë atë cka student do të dijë, do të jetë në gjendje të bëjë dhe vlerat që do të përfaqësojë. Rezultatet e synuara të të nxënës të programit të studimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe përshkruesit e nivelit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Poashtu, rezultatet janë tëkrahaseshme me programe ndërkombëtare. Kështu, në përfundim të studimeve, të diplomuarit do të jenë në gjendje të:

- Analizojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë praktikën bashkëkohore për zhvillimin dhe edukimin në fëmijëri të hershme;
- Zbërthejnë kurrikulën në aktivitete të planifikuara për fëmijët sipas grup-moshës, duke e orientuar punën e tyre sipas qasjeve bashkëkohore me fëmijën në qendër;
- Aplikojnë metodologjinë bashkëkohore gjatë punës me fëmijë, duke u mundësuar atyre zhvillimin në mënyrë tërësore (psh. të zhvillojnë aftësi fizike, gjuhësore, matematikore, shkencore, artistike e të përgatiten për jetë, etj.);
- Shfrytëzojnë teknologjinë për të kryer aktivitete edukative dhe e integrojnë atë në edukim;
- Përdorin forma të ndryshme të vëzhgimit për të identifikuar dhe dokumentuar potencialet, nevojat dhe interesat e fëmijëve në fëmijëri të hershme;
- Mundësojnë qasje gjithëpërfshirëse në procesin e zbatimit të planit dhe programit, duke i dhënë mundësi të barabarta secilit fëmijë;
- Përgatisin mjedisin për të siguruar ndërveprime midis fëmijëve, ndërveprime midis fëmijëve dhe të rriturve dhe për të krijuar mundësi për integrim të natyrshëm ndërfaqësor;
- Promovojnë bashkëpunimin institucion parashkollor-familje-komunitet dhe aplikojnë qasje të ndryshme për partneritet me familjen dhe komunitetin;
- Analizojnë në vazhdimësi praktikën e tyre profesionale dhe inkurajojnë një kulturë bashkëpunuese të reflektimit, duke ndarë përvojat dhe mësimet së bashku me kolegët dhe bashkëpunëtorët;
- Angazhohen aktivisht për të qenë në hap me zhvillimet shkencore me qëllim që të avancojnë shkathtësitë profesionale dhe të krijojnë një kulturë të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- Promovojnë vlerat, besimet, qëndrimet mbi të cilat zhvillohet identiteti shoqëror dhe kombëtar bazuar në vlerat demokratike për arsimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në vend;

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Programi Edukimi në Fëmijërinë e Hershme

VITI I PARË					
SEMESTRI I					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	TEORI E EDUKIMIT	3	1	6
2	O	HYRJE NË PSIKOLOGJI	3	1	6
3	O	GJUHË SHQIPE I	3	2	6
4	O	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (LINDJE - 3 VJEÇ)	2	2	6
5	O	TIK-u PËR EDUKATORE	3	2	6
			14	8	30
SEMESTRI II					
1	O	EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË(3 -6 VJEÇ)	2	2	6
2	O	GJUHË SHQIPE II	3	2	6
3	O	ARTI FIGURATIV PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	2	5
4	O	EDUKIM FIZIK PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	2	5
5	Z	TË NXËNIT PËRMES LOJËS	2	0	4
6	Z	SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE	2	0	4
7	Z	SHKATHTËSI PËR JETË	2	0	4
8	Z	KULTURË SHKRIMI	2	0	4
			13	8	30
*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).					

VITI I DYTË					
SEMESTRI III					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	GJITHËPËRFSHIRJA NË FËMIJËRI TË HERSHME	3	2	6
2	O	PSIKOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS	2	2	5
3	O	KONCEPTET MATEMATIKORE NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	2	6
4	O	MUZIKA PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	2	5
5	Z	EDUKIMI PER VLERA	2	0	4
6	Z	SHKATHTËSITË DIGJITALE	2	0	4
7	Z	PARTNERITETI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN	2	0	4
8	Z	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	2	0	4
9	Z	LOJËRAT SKENIKE	2	0	4
			14	8	30

\*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

SEMESTRI IV					
1	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (LINDJE -3 VJEÇ) (6 JAVË)	3	0	6
2	O	KONCEPTET GJEOMETRIKE NË FËMIJËRINË E HERSHME	3	2	6
3	O	INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE	2	2	5
4	O	GJUHË ANGLEZE	3	1	5
5	Z	ZHVILLIMI DHE EDUKIMI GJUHËSOR NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
6	Z	STRATEGJITË E EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
7	Z	KREATIVITETI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
8	Z	HISTORI KOMBËTARE PËR FËMIJË	2	0	4
9	Z	PSIKOLOGJI SOCIALE DHE E KOMUNITETIT	2	0	4
			15	5	30

\*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

VITI I TRETË					
SEMESTRI V					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I KURRIKULËS	2	2	5
2	O	PSIKOLOGJI E EDUKIMIT	2	2	5
3	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III (3 -6 VJEÇ) (6 JAVË)	3	0	6
4	O	SHKENCAT E NATYRËS NË FËMIJËRI TË HERSHME	3	2	6
5	Z	SHKATHTËSITË KËRKIMORE	2	0	4
6	Z	ETNOLOGJI DHE LETËRSI POPULLORE	2	0	4
7	Z	LOJËRAT MATEMATIKORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
8	Z	IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMET E HERSHME	2	0	4
9	Z	LOJËRAT NË NATYRË	2	0	4
			14	6	30

\*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z)

SEMESTRI VI					
Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	VLERËSIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME	2	2	5
2	O	EDUKIMI SHËNDETËSOR	3	0	5
3	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3	2	6
4	O	SHKENCAT SHOQËRORE NË FËMIJËRI TË HERSHME	3	2	6
5	Z	METODOLOGJIA MONTESORI	2	0	4

6	Z	ZHVILLIMI SOCIO-EMOCIONAL	2	0	4
7	Z	EDUKIMI PËRMES STEM	2	0	4
8	Z	EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM	2	0	4
9	Z	LOJËRAT MUZIKORE	2	0	4
			15	6	30

\*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

Viti i katërt

Semestri VII

Kursi	O/Z	Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE	2	2	6
2	O	MENAXHIMI I KLASËS	2	2	5
3	O	DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA	3	2	6
4	O	PUNË DORE ME MODELIM	2	2	5
5	Z	ZHVILLIMI KOGNITIV	2	0	4
6	Z	METODOLOGJIA REGGIO EMILIA	2	0	4
7	Z	RUTINAT MATEMATIKORE	2	0	4
8	Z	KUJDESI DHE TË USHQYERIT PËRFËMIJËRINË E HERSHME	2	0	4
9	Z	UDHËHEQJA E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE	2	0	4
			13	8	30

\*Studenti zgjedh dy kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

Semestri VIII

Kursi		Emri i kursit	L	U	ECTS
1	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	2	6
2	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV (8 javë)	3	0	14
3	O	PROVIMI PËRFUNDIMTAR/PUNIMII DIPLOMËS			10
			5	2	30

## 4. PËRSHKRIMET E KURSEVE

### Përshkrimi për secilin kurs

#### TEORI E EDUKIMIT

Kursi fokusohet në teoritë themelore të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe ju ndihmon studentëve të njihen me parimet dhe filozofinë e edukimit. Gjatë këtij kursi studentët do të njihen me teori të ndryshme të edukimit, gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë. Përgjatë diskutimit dhe reflektimit studentët do të kenë mundësi të fokusohen në analizat e pikëpamjeve të shumëfishta të teorive të edukimi dhe gradualisht të ndërtojnë filozofinë e tyre përkitazi me teoritë e edukimit dhe aplikimit praktik të tyre.

#### HYRJE NË PSIKOLOGJI

Kjo është një lëndë hyrëse në psikologji dhe ka për qëllim t'i njoftojë studentët me fushën e studimit të psikologjisë, lëndën e studimit të saj, parimet, detyrat teorike dhe praktike, teoritë themelore, si dhe historinë e zhvillimit të psikologjisë si shkencë, metodologjinë dhe rendesine e zbatimit të psikologjisë në fushën e edukimit. Kursi poashtu shtjellon proceset psikike bazë, veçoritë dhe karakteristikat e proceseve psikike për të kuptuar me mire sjelljen, afekcionin dhe të menduarit. Njohuritë nga kursi u ofrojnë studentëve një perspektivë të plotë mbi botën, njohjen e vetes dhe të tjerëve dhe të kuptuarit e kompleksitetit të sjelljes njerëzore (me theks të vecantë në fëmijërinë e hershme). Cdo kapitulli i këtij kursi i ofron vëmendje diskutimit dhe studimit të diversitetit njerëzor (me theks tek fëmijëria e hershme dhe moshë parashkollore), gjuhës, mendimit dhe kulturës. Secili kapitull ofron ushtrime të llojit "Të mendojmë në mënyrë kritike për..."tema që nxisin studentët të mbajnë qëndrim kritik duke ngritur pikëpyetje mbi metodat e përdorura në studime përkatëse, duke marrë në konsideratë shpjegime alternative për faktet dhe konstatimet e supozuara. ngritjen e shkathtësive të studentëve/edukatorëve para shërbimit për të zbatuar konceptet dhe parimet psikologjike në fushën e edukimit në fëmijërinë e hershme.

#### GJUHË SHQIPE I

Përmes këtij kursi studentët do t'i zgjerojnë njohuritë e tyre paraprake përkitazi me: prejardhjen e gjuhës shqipe, dokumentimin e saj, dialektet dhe rrugën e zhvillimit të saj. Ata do të njihen teorikisht dhe praktikisht edhe me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore: drejtshqiptimin, dallimin e tingujve nga morfemat, klasifikimin e tingujve, nyjëtimin e tyre; për theksin, dukuritë fonetike etj. Po ashtu do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në pjesën e morfologjisë: sistemi fjalëformues i gjuhës, si dhe për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emri, mbiemri, numërori, përemri me kategoritë e tyre morfologjike.

#### EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (lindje -3 vjeç)

Lënda: Edukimi në fëmijërinë e hershme me praktikë (lindje – 3 vjeç), përmban njohuritë themelore në fushën e edukimit të fëmijëve nga viti i parë i lindjes deri në moshën 3 vjeç.

Duke filluar me sqarimin e nocioneve themelore dhe terminologjisë profesionale dhe parimeve bazë të edukimit të hershëm. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë edhe specifikat mbi edukimin e institucionalizuar, rolin e edukatores, rolin e ambientit, bashkëpunimit me familjen dhe komunitetin etj. Lënda synon që studentët të përvetësojnë njohuri dhe shkathtësi për të ofruar veprimtari edukative në mënyrë që edukimi i institucionalizuar të jetë në funksion të mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijës. Praktika e cila do të organizohet në kuadër të kësaj lënde, e cila do të mbahet në IP në grup-moshat 0- 3 vjeç, do të ndihmojë studentët të observojnë dhe reflektojnë për lëndën dhe ta ndërlihin atë me praktikën.

#### TIK-u PËR EDUKATORE

Kursi fokusohet në aftësimin teorik dhe praktik të studentëve për të shfrytëzuar TIK-un për të mbështetur zhvillimin socio-emocional, kreativitetin dhe të menduarit kritikë. Përkatësisht për të shfrytëzuar: Lodrat e programueshme, TIK Lodrat (ICT toys), Teknologjitë e Edukimit dhe Teknologjitë e Internetit në aktivitete me fëmijë. Kursi shtjellon nocionet e ndërveprimit të fëmijës me TIK-un në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të tij. Studentët mësojnë se si t'i përdorin këto lojëra dhe teknologji në kontekstin "shkak – efekt", për të ndihmuar zhvillimin socio-emocional, kreativitetin dhe të menduarit kritikë të fëmijëve, t'i ndihmojnë fëmijët që të kuptojnë se si punojnë paisjet themelore të TIK-ut dhe si mund të përdoren gjatë jetës së tyre të përditshme në mënyrë të drejtë dhe efikase.

#### EDUKIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME ME PRAKTIKË (3 -6 vjeç)

Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi të dinë specifikat e punës së edukatoreve me fëmijët e grupmoshës 3-6 vjeç. Do të njohohen me strategjitë e punës që duhet të kenë me fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Duke filluar nga përshtatja e ambientit, përzgjedhja e mjeteve dhe materialeve, lodrave, planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve, vlerësimit të fëmijëve, bashkëpunimi me familjen dhe orientimi në dokumente zyrtare të cilat shërbejnë për fëmijët e kësaj grupmoshe. Gjatë këtij kursi, studentët do të kenë mundësi që të shkojnë në praktikë. Praktika pedagogjike do të organizohet nëpër institucione parashkollore, konkretisht në grupet 3-6 vjeç të fëmijëve.

#### GJUHË SHQIPE II

Në këtë kurs studentët do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprake, përkthimi me: foljen dhe kategoritë gramatikore të saj, pjesët e pandryshueshme të ligjëratë (ndajfolja, parafjala, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma). Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e organizimit të tekstit: objekti i studimit të sintaksës, klasifikimi i togfjalëshave, klasifikimi dhe llojet e fjalive, gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë, klasifikimi dhe llojet e fjalisë së përbërë.

#### ARTI FIGURATIV PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë themelore si: njohja e ngjyrave bazë bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen. Me zhvillimin e kësaj kursi studentët do të aftësohen për zhvillimin e aftësive tek fëmijët nga faza paranatale e deri të përfundimi i fëmijërisë.



## EDUKIM FIZIK PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Lënda ofron informacione në lidhje me edukimin fizik përfshirë edhe atë lëvizor në fëmijërinë e hershme që nga lindja deri në moshën 6 vjeçare. Edukimi fizik është mjaft i rëndësishme dhe duhet parë ngushtësisht i lidhur me të gjitha fushat e tjera të edukative dhe zhvillimore. Lënda ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e edukimit fizik, shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.

## TË NXËNIT PËRMES LOJËS

Ky kurs do të ofrojë njohuri për rëndësinë e të nxënimit që fëmijët e arrijnë përmes lojës. Studentët do të kenë mundësi të kuptojnë teori të ndryshme për të nxënimit përmes lojës, do të kenë mundësi të ushtrojnë shkathtësitë dhe kreativitetin e tyre, duke planifikuar dhe organizuar lojëra me karakter edukativ, të cilat do të bazohen në fushat zhvillimore të parapara me Kurrikulën Bërtham për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërtham 1 për Klasën Përgatitore. Përmes këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të reflektojnë dhe analizojnë rolin e edukatores në përcaktimin, planifikimin dhe orientimin e fëmijëve gjatë procesit të lojës. Do të diskutohen po ashtu veçoritë e lojës në raport me moshën e fëmijës dhe specifikat që ka ajo për secilën grup-moshë (nga 0-6 vjeç). Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet edhe rolit të edukatores për të vëzhguar fëmijët gjatë procesit të lojës, përmes së cilësdo të kenë mundësi të identifikojnë interesat dhe nevojat e fëmijëve në baza individuale.

## SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Kursi realizohet në formë të punëtorisë dhe synon që të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuri dhe shkathtësi lidhur me konceptet dhe modelet kryesore të komunikimit; të kuptuarit e llojeve të ndryshme të komunikimit dhe të funksioneve bazë të komunikimit. Tutje, kursi shtjellon njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e tjera, për t'i aftësuar studentët ti zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët, si dhe t'i njohin e kuptojnë parakushtet e komunikimit efektiv. Kursi shtjellon perspektivat teorike dhe gjetjet nga hulumtimet më të reja dhe ofron shembuj praktik për të zhvilluar shkathtësitë e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar me fëmijë; për të nxitur bashkëpunimin, për të zhvilluar empatinë dhe dëgjimin aktiv, për t'u njohur me stilet dhe mënyrat e zgjidhjes së konflikteve përmes shkathësive të komunikimit si dhe për të zhvilluar të menduarit kritik të tyre lidhur me potencialet e shkathësive të komunikimit.

## SHKATHTËSI PËR JETË

Ky kurs është dizajnuar në atë mënyrë që të përkrahë zhvillimin profesional të edukatorëve, duke ndihmuar ata që të thellojnë të kuptuarit e tyre mbi shkathtësitë e buta si dhe t'u sigurohen atyre resurse adekuate për t'u ndihmuar që të jenë të shkathtë që parimet e teorive të zhvillimit të fëmijës t'i transformojnë në eksperiencë praktike gjatë punës edukativo-arsimore me fëmijë. Për më tepër, kursi adreson domosdoshmërinë dhe nevojën e përkrahjes së këtyre shkathtësive të edukatorët para dhe gjatë shërbimit, në mënyrë që përmes këtyre shkathtësive edukatorët të reflektojnë në qasje përkrahëse lidhur me zhvillimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme; të përkrahin marrëdhëniet e mira ndërpersonale me Institucionet parashkollë, me familjen dhe komunitetin. Disa nga shkathtësitë bazë që trajton kursi dhe relevancën e tyre për jetë dhe zhvillim profesional të edukatorëve, në funksion të përkrahjes së zhvillimit dhe edukimit në fëmijëri të hershme janë: shkathtësive e mira të komunikimit, krijimi

dhe mbajtja e marrëdhënieve me bazë reciprociteti, shkathtësitë organizative, menaxhimi emocional, shkathtesite e lidershipit, punë ekipore, kreativiteti, kurioziteti dhe shkathtësitë e zgjidhjes së konflikteve.

#### KULTURË SHKRIMI

Ky kurs u mundëson studentëve t'i thellojnë njohuritë për rregullat, normat dhe parimet e drejtshkrimit të shqipes standarde, si dhe zbatimit të tyre në praktikë. Po ashtu, kursi ofron mundësi të shqyrtimit të problemeve kryesore, që dalin si sprovë e jetësimit praktik të normës së shqipes standarde, duke përfshirë edhe faktorët sociolinguistikë/jashtëgjuhësorë që e përcaktojnë shkallën e njohjes dhe të aplikimit të saj.

#### GJITHËPËRFSHIRJA NË FËMIJËRINË E HERSHME

Kursi ofron njohuri të avancuara nga fusha e edukimit gjithëpërfshirës në fëmijërinë e hershme. Në këtë kurs trajtohen tema që kanë të bëjnë me nocionet themelore të edukimit gjithëpërfshirës, zhvillimin e legjislacionit botëror dhe vendor në mbështetje të realizimit të kulturës gjithëpërfshirëse, rolin e institucionit parashkollor dhe të edukatores në krijimin e klimës gjithëpërfshirëse, bashkëpunimin me qendrat burimore, edukatorët mbështetës, prindërit, profesionistët dhe komunitetin në funksion të gjithëpërfshirjes, gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, indeksin për gjithëpërfshirje, hartimin dhe implementimin e planit individual të arsimit (PIA), si dhe etikën dhe mbrojtjen e fëmijëve e cila është përparësi e proceseve gjithëpërfshirëse.

#### PSIKOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË FËMIJËS

Kursi adreson zhvillimin e gjithëmbarshtëm të fëmijës në fëmijëri të hershme dhe ofron një eksplorim të thellë të zhvillimit fizik, kognitiv dhe socio-emocional të fëmijëve nga lindja deri në moshën 8 vjeç. Fokusi është në të kuptuarit e momenteve kyçe të zhvillimit, faktorëve ndikues dhe implikimeve praktike për kujdestarët dhe edukatorët. Kursi shtjellon nocionet e zhvillimit të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin

ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Studentët mësojnë për teoritë dhe studimet sistematike të zhvillimit të fëmijës, fazat e zhvillimit nga moshë parantale deri në përfundim të fëmijërisë, karakteristikat e vecanta të secilës fazë dhe rreziqet që shoqërohen me atë fazë. Studentët aftësohen për aplikim të parimeve të psikologjisë së zhvillimit në skenarë të botës reale, të tilla si mjediset edukative, praktikat e prindërimit dhe ndërhyrjet që synojnë promovimin e zhvillimit pozitiv. Kursi shtjellon edhe çështjet etike në kërkimin dhe praktikën zhvillimore, duke theksuar rëndësinë e marrjes parasysh të mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve në faza të ndryshme të zhvillimit.

#### KONCEPTET MATEMATIKORE NË FËMIJËRINË E HERSHME

Në këtë kurs studenti përvetëson këto koncepte themelore (në situata të jetës së përditshme): numri, numërimi, përqindja, veprimi aritmetik, logjika, bashkësia, relacioni (lidhja), pasqyrimi, barazimi, jobarazimi, masa, matja, popullacioni, mostra, e dhëna, frekuenca, histogrami, mesatarja, mediana, moda dhe probabiliteti (gjasa).

## MUZIKA PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Kursi ofron njohuri dhe shkathtësi themelore muzikore të cilat gërshëtohen në mënyrë teorike dhe praktike. Kursi fokusohet në aftësimin e studentëve për të njohur/kuptuar më mirë konceptet bazike, ligjshmëritë dhe informacionet për mjetet shprehëse muzikore, format dhe llojet të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikës. Kursi synon të përgatitë studentët që të njohjin dhe praktikojnë mjetet shprehëse muzikore (notat muzikore, emërtimi, vlera, lartësia, ritmi etj.) të cilat pastaj duke u gërshetuar me kurset vijuese, studentëve u hapin rrugën për interpretim të pavarur (vokal dhe instrumental) dhe aplikimin e metodave dhe strategjive në mësimdhënien e edukimit muzikor.

## EDUKIMI PËR VLERA

Edukimi i vlerave është një qasje e qëllimshme dhe sistematike ndaj mësimdhënies dhe rrënjës së vlerave thelbësore, etikës, parimeve dhe virtyteve tek individët brenda mjediseve edukative. Edukimi i vlerave është i rëndësishëm në formësimin e karakterit të individëve, në udhëheqjen e veprimeve të tyre dhe në nxitjen e një kulture respekti, ndjeshmërie dhe sjelljeje etike. Ai luan një rol kryesor në përgatitjen e individëve për të orientuar drejt dilemave komplekse etike dhe për të kontribuar pozitivisht në shoqëri bazuar në një themel të vlerave të forta etike. Ky kurs synon të zhvilloj individë të përgjegjshëm që mishërojnë vlera pozitive dhe kontribuojnë në një shoqëri më të drejtë, më empatike dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë kurs trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse integrimi i edukimit për vlera brenda kurrikulës, roli i edukatorëve dhe strategjitë e mësimdhënies në këtë aspekt.

## SHKATHTËSITË DIGJITALE

Lënda trajton teknologjinë dhe mediat dixhitale si mjete për mësimdhënie dhe mësim në epokën dixhitale. Lënda fokusohet në përdorimin e teknologjisë si një mjet për zhvillimin e të menduarit social-emocional dhe kritik, duke rritur shkrim-leximin dhe kreativitetin dixhital, për të forcuar lidhjen e shkollës në shtëpi. Studentët mësojnë se si të përdorin hapësirat krijuese në vitet e hershme për të rritur shkrim-leximin dhe krijimtarinë dixhitale, pakësimin dixhital.

## PARTNERITETI ME FAMILJEN DHE KOMUNITETIN

Lënda "Partneriteti me familjen dhe komunitet" ka për qëllim të përqendrohet në zhvillimin dhe ruajtjen e bashkëpunimit ndërmjet institucionit parashkollor, familjes dhe komunitetit. Përmbajtja e shkurtër e kësaj lënde përfshin teorikisht dhe praktikisht temat kryesore të praktikave që promovojnë bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet Institucioneve parashkollore dhe familjes, në veçanti. Në përgjithësi, lënda Partneriteti me familje dhe komunitet, përpjeket të sigurojë një kuptim të thellë dhe praktik të rëndësishëm të partneritetit me familjen dhe komunitetin në kontekstin e edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme. Studentët përgatiten për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie të suksesshme me prindërit dhe komunitetin, duke promovuar një mjedis të pasur dhe mbështetës veqanërisht për fëmijët nga lindja deri në moshën 6 vjeqare.

## METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR

Kursi metodologji e leximit letrar përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare që krijohen dhe perceptohen nga grupmoshat e fëmijëve parashkollor përfshirë edhe grupmoshat e hershme. Ky kurs ofron njohuri të avancuara nga fusha e metodologjisë së leximit letrar. Studentët do të njihen me metodat bazike sesi të interpretohet mirëfilli dhe pa paragjykim një tekst letrar. Në këtë kurs do të trajtohen rëndësia e leximit, kuptimit dhe interpretimit të teksteve letrare në varësi të moshës së fëmijëve.

## LOJËRAT SKENIKE

Në këtë kurs studentët do të kenë mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike të përgatiten për njohjet me rëndësinë e bashkëpunimit të studentit dhe fëmijëve në fëmijëri të hershme si dhe për zbatimin e kësaj njohurie në praktikë. Studentët do të kenë mundësinë që të njohin dhe aplikojnë forma të ndryshme të lojërave dramatike dhe atyre lojërave skenike. Lojërat skenike ndahen në katër pjesë. Stanislavski ka thënë: "Secili aktor do të jetë në situatë të luaj role jo vetëm prej një epoke, po prej epokave të ndryshme dhe me nacionalitete të ndryshme, moshave të ndryshme poashtu" prandaj studenti-aktor duhet të zotërojë aftësi të ndryshmeve dhe duhet t'i zhvillojë ato.

## PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II

Përmes praktikës pedagogjike studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara. Përmes Doracakut të Mësimi Praktik studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës edukative. Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët dërgohen në institucione parashkollore. Fokusi do të jetë tek zhvillimi i aftësive të vrojtimit dhe të shkathëtsive të reflektimit. Gjatë "Praktikës pedagogjike II" studentët dërgohen në grupet edukative në grupmoshat nga 0-3 vjeç, kjo për arsye që studentët gjatë studimeve të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht për 6 javë nga 3 ditë në javë duke asistuar edukatoren në të gjitha aktivitetet përgatitore dhe të punës së drejtë përdrejtë me fëmijë. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin portfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktikë.

## KONCEPTET GJEOMETRIKE NË FËMIJËRINË E HERSHME

Në këtë kurs do të shqyrtohen teoritë për zhvillimin e të menduarit për hapësirën dhe kuptimet gjeometrike në fëmijërinë e hershme. Studentët do të përvetësojnë këto koncepte themelore gjeometrike: Figurat gjeometrike, madhësitë dhe raportet e tyre, pozitat në hapësirë, lëvizjet dhe orjentimin, si dhe do të aftësohen për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të përshtatshme me fëmijët 0-6 vjeç dhe në veçanti në klasën përgatitore.

## INTERPRETIMI NË INSTRUMENTE

Kursi është i dizajnuar për t'i përgatitur studentët që të interpretojnë në instrumente muzikore me tastierë (piano, sintisajzer) dhe instrumentet fëmijërore (sidomos ato nga grupi i instrumenteve të Orffit). Përmes këtij kursi studentët do të aftësohen të interpretojnë këngë të ndryshme me specifika për grupmoshat parashkolllore 0- 3 vjec dhe 3-6 vjec. Këngët do t'i demonstrojnë në mënyrë praktike duke aplikuar teknika funksionale të interpretimit.

## GJUHË ANGLEZE

Gjuhë angleze është kurs semestral obligativ, i cili i ekspozon studentët ndaj një sërë situatash komunikative në gjuhën angleze, të cilat kanë të bëjnë me tema të ndryshme nga përditshmëria, nëpërmjet të cilave studentët do të jenë në gjendje t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre komunikuese dhe njëkohësisht t'i përmirësojnë të gjitha shkathtësitë themelore gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit në funksion të rrjedhshmërisë dhe saktësisë. Temat e mbuluara gjatë kursit do të përfshijnë një llojllojshmëri të ushtrimeve gramatikore dhe të leksikut, të cilat do t'u ndihmojnë studentëve të arrijnë një zotërim të kënaqshëm të gjuhës angleze, duke pasur gjithmonë në fokus gërshetimin e kompetencës dhe performancës gjuhësore si imperativ për zotërimin e një gjuhe të huaj.

## ZHVILLIMI DHE EDUKIMI GJUHESOR NË FËMIJËRINË E HERSHME

Mënyra se si fëmijët e përvetësojnë gjuhën është komplekse dhe mësimi i gjuhës është një moment historik kryesor zhvillimor në fëmijërinë e hershme. Ky modul eksploron se si zhvillohet gjuha prej lindjes dhe gjashtë vjetëve në vazhdim, duke përfshirë edhe fëmijët që flasin dy ose më shumë gjuhë. Të kuptuarit se si ndodh mësimi i gjuhës dhe se si edukatorët dhe kujdestarët mund t'i mbështesin fëmijët e vegjël në këtë proces është pjesë përbërëse e rolit të edukatorëve. Ky modul do të eksplorojë teoritë aktuale të zhvillimit të gjuhës dhe do të ofrojë shembuj praktikë të mënyrave për të lehtësuar zhvillimin e gjuhës në vitet e hershme. Ky kurs synon të zhvilloj individë të përgjegjshëm që mishërojnë vlera pozitive dhe kontribuojnë në një shoqëri më të drejtë, më emaptike dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë kurs trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse integrimi i edukimit për vlera brenda kurrikulës, roli i edukatorëve dhe strategjitë e mësimdhënies në këtë aspekt.

## STRATEGJITË E EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME

Lënda "Strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme " ka për qëllim të përqendrohet në shtjellimin e temave që lidhen me strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme, si fushë shumë e rëndësishme për punën me fëmijë të moshës së hershme. Përmbajtja e shkurtër e kësaj lënde përfshin teorikisht dhe praktikisht temat kryesore të çështjeve që lidhen me strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme, pastaj punës që bëhet në institucione parashkolllore, lojën, si veprimtari kryesore e fëmijëve të kësaj moshe, dhe promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve parashkolllore dhe prindërve në veçanti. Në përgjithësi, lënda Strategjitë e edukimit në fëmijërinë e hershme, përpjeket të sigurojë një kuptim të thellë dhe praktik të rëndësisë që ka puna me fëmijë në fëmijërinë e hershme. Studentët përgatiten për të ndërtuar dhe ruajtur marrëdhënie të suksesshme me prindërit dhe profesionistët tjerë, duke promovuar një mjedis të pasur dhe mbështetës veçanërisht për fëmijët nga lindja deri në moshën 6 vjeçare.

## KREATIVITETI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Kreativiteti në fëmijërinë e hershme gjatë kursit do të fokusohen çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe të kuptuarit e procesit të punës kreative artistike për fëmijërinë e hershme. Fillimisht jepet një pasqyrë rreth teorive të ndryshme që paraqesin bindje dhe qëndrime rreth sigurimit të eksperiencave kreative në fushat e ndryshme të artit e të punës ndaj fëmijërinë e hershme. Në vazhdim do të trajtohen nevojat, veçantitë dhe përfitimet nga një qasje e tille edukative, si dhe njëkohësisht do të mendohen e analizohen modelet e mësimit për këta fëmijë, në varësi me synimet e një kurrikule të integruar në përgjithësi, si dhe nga karakteristikat e zhvillimit, nevoja dhe interesat e secilit fëmijë në veçanti. Me rëndësi të veçantë është dhe planifikimi, rregullimi, dhe menaxhimi i ambientit kreativ në klasë, materialet dhe burimet, si dhe vlerësimi i shprehjes kreative të fëmijëve të kësaj moshe. Kreativiteti në fëmijërinë e hershme do të shfrytëzohen njohuri themelore, si: Logjika artistike, imagjinata, zhvillimi i intelegjencës, shprehja figurative përmes vizatimit, ilustrimit, pikturimit, modelimit, komunikimi përmes figurave, simbolet e vijave dhe ngjyrave. Kreativiteti në fëmijërinë e hershme i krijon mundësi studentit të fitojë njohuri dhe t'i interpretojë ato në mënyrë origjinale. Ky program do ta ndihmojë studentin të zhvillojë aftësitë e tij për të përcaktuar, për të përmirësuar dhe për të zgjidhur problemet e tij estetike që i dalin, për të qenë sa më i suksesshëm në punën profesionale dhe në jetë.

## HISTORI KOMBËTARE PËR FËMIJË

Kursi synon të përgatisë edukatorë të cilët do të jenë në gjendje të tregojnë kuptimin e ngjarjeve historike që kanë mësuar, duke bërë lidhjet dhe duke tërhequr kontraste ndërmjet periudhave të ndryshme dhe zonave të studiuara, duke përdorur njohuritë e tyre historike për të analizuar të kaluarën dhe për të shpjeguar se si mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Edukatorët, gjithashtu, mësojnë se si, lloje të ndryshme të burimeve historike dhe letrare përdoren për të bërë shpjegimin për të kaluarën. Ky kurs realizohet përmes integrimet të lëndve të tjera, siç janë: Arti, Letërsia për Fëmijë dhe Gjeografia. Kursi është dizajnuar në mënyrë që të frymëzojë dhe të rrisë kuriozitetin e fëmijëve për të ditur më shumë për të kaluarën historike të popullit tonë.

## PSIKOLOGJIA SOCIALE DHE E KOMUNITETIT

Ky kurs i specializuar është krijuar për të pajisur edukatorët e fëmijërisë së hershme me një kuptim gjithëpërfshirës të parimeve të psikologjisë sociale dhe të komunitetit, të përshtatura me kontekstin unik të edukimit të fëmijërisë së hershme. Pjesëmarrësit do të eksplorojnë dinamikat psikologjike që ndikojnë në zhvillimin, ndërveprimet dhe angazhimin e fëmijëve brenda mjediseve sociale. Kursi integron kornizat teorike, metodologjitë e kërkimit dhe strategjitë praktike të rëndësishme për nxitjen e mjediseve pozitive sociale dhe komunitare në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme.

### ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I KURRIKULËS

Kursi fokusohet në marrëdhëniet mes të teorive të zhvillimit, filozofisë, praktikës dhe zhvillimit të kurrikulës bazuar në nevojat dhe intereset e fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e talentuar. Do të analizohen spektri i gjerë i kurrikulave për edukimin e hershëm të fëmijëve, përfshirë edhe Kornizën Kurrikulare të Kosovës, përkatësisht Kurrikulën Bërthamë për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërthamë 1 pjesë e së cilës është edhe klasa përgatitore. Përmes këtij kursi studentët do të kenë mundësi të njihen me rëndësinë e Kurrikulës në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve në punën e tyre të përditshme. Do të kenë mundësi që të analizojnë dhe zbërthejnë në praktikë Kurrikulën Bërthamë për edukimin në fëmijëri të hershme 0-5 vjeç dhe Kurrikulën Bërthamë 1 për klasën përgatitore. Përmes së cilës studentët do të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike për planifikimin e aktiviteteve bazuar në kompetenca.

### PSIKOLOGJI E EDUKIMIT

Kursi "Psikologji e Edukimit" në Edukimin në Fëmijërinë së Hershme është një komponent themelor për edukatorët që punojnë me fëmijët e vegjël. Duke u thelluar në teoritë e zhvillimit të fëmijëve, kursi ofron një kuptim të nuancuar të mendjes së re në zhvillim. Ai fuqizon edukatorët që të përshtatin qasjet e mësimdhënies, duke theksuar stile të ndryshme të të mësuarit dhe strategji për gjithëpërfshirje. Duke trajtuar zhvillimin social dhe emocional, kursi udhëzon edukatorët në krijimin e klasave pozitive, emocionalisht të sigurta. Diversiteti kulturor dhe individual janë pika qendrore, duke i përgatitur edukatorët për të përqaftuar dallimet dhe për të nxitur një kulturë mësimore gjithëpërfshirëse. Kursi i pajis edukatorët me strategji efektive të menaxhimit të sjelljes, thekson vlerësimin dhe ndërhyrjen e hershme dhe thekson rëndësinë e përfshirjes së prindërve. Në përgjithësi, ai shërben si një bazë për krijimin e mjediseve mësimore edukative, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për zhvillimin.

### PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III

Gjatë praktikës pedagogjike III, studentët do të kenë mundësi që njohuritë e fituara teoritikisht, t'i zbatojnë edhe në praktikë me punë me fëmijë të moshës 3 - 6 vjeç. Fokusi gjatë kësaj praktike do të jetë në zhvillimin e shkathtësive për të planifikuar dhe zbatuar strategji të ndryshme të të nxënies bazuar në potencialet e fëmijëve, bazuar në njohuritë paraprake të studenteve nga kjo lëndë. Për më tepër studentët do të aftësohen për të planifikuar aktivitete, menaxhuar grupin duke përdorur forma dhe metoda ndërvepruese të të nxënies përmes lojës dhe në mënyrë të vazhdueshme do të vëzhgojnë dhe dokumentojnë zhvillimin e fëmijëve të moshës 3 – 6 vjeç.

### SHKENCAT E NATYRËS NË FËMIJËRI TË HERSHME

Ky kurs është i dizajnuar për të ndihmuar studentët e programit parashkollor në zhvillimin e kompetencave dhe perspektivave të nevojshme për të qenë edukatorë të suksesshëm të fëmijëve të vegjël parashkollor. Shkenca e natyrës në fëmijërinë e hershme është një kurs që përveç përmbajtjes shkencore do të adresoj parimet dhe praktikatat në mësimdhënien e

shkencës së natyrës tek fëmijët. Eksplorimi dhe ekzaminimi i përmbajtjes dhe koncepteve të planprogramit të shkencave në fëmijërinë e hershme është pjesë thelbësore e këtij kursi. Edukatorët gjatë këtij kursi do të mësojnë për, dhe praktikojnë, metoda metodologjike, materiale për stimulim, eksplorim, zbulim dhe mësimdhënies të shkencës së natyrës. Përveç njohurive, edukatorët do të zhvillojnë shkathtësi dhe qëndrime të caktuara në mënyrë që ata të mund t'i udhëzojnë fëmijët drejt materialeve më të gjera, shkencore dhe kreative.

#### SHKATHTËSITË KËRKIMORE

Ky kurs synon që t'i pajisë studentët me shkathtësi thelbësore kërkimore që nxisin një qasje reflektuese dhe të orientuar drejt kërkimit në praktikën e tyre profesionale. Përmes eksplorimit teorik dhe praktik të të qenit edukatorë kërkues/hulumtues, studentët do të zhvillojnë aftësinë për të bërë pyetje domethënëse, për të analizuar në mënyrë kritike informacionin dhe për të aplikuar praktika të bazuara në dëshmi/hulumtim në fushën e edukimit në fëmijëri të hershme.

#### ETNOLOGJI DHE LETËRSI POPULLORE

Etnologjia dhe Letërsi Popullore mëton që studentëve t'u mundësojë:

- Të kuptojnë diversitetin kulturor
- Të kuptojnë mënyrat dhe format e ruajtjes së trashëgimisë kulturore
- Të kuptojnë metodat e krijimit, të shfrytëzimit dhe të ruajtjes së dokumentacionit kulturor
- Të kuptojnë dhe të jenë pjesë e shkëmbimit dhe e mirëkuptimit kulturor
- Të fitojnë njohuri dhe të zotërojnë mënyrat dhe metodat e politikave informuese dhe të zhvillimit
- Të hynë në botën dhe të jenë pjesë e mjedisit të studimit dhe kërkimit akademik

#### LOJRAT MATEMATIKORE PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Në këtë kurs studentët përvetësojnë dijen bazike lidhur me mënyrat se si e mësojnë më lehtë fëmijët matematikën në pajtim me moshën e tyre. Ata do të përgatiten që dijen e fituar në kursin Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme dhe Konceptet gjeometrike në fëmijërinë e hershme ta aplikojnë për t'i angazhuar fëmijët në institucionet parashkollore që t'i kuptojnë konceptet themelore matematikore, gjeometrike dhe ta zhvillojnë të menduarit matematik të fëmijëve nëpërmjet lojës dhe aktiviteteve në ambientet ku ata jetojnë. Kursi ofron lojëra dhe aktivitete bashkëkohore për zhvillimin e koncepteve themelore matematikore: Kursi përmban llojet e problemeve të cilat për bazë kanë numrat, pozitën dhe simetrinë e objekteve, formën, hapësirën dhe matjen.

#### IDENTIFIKIMI DHE INTERVENIMET E HERSHME

Ky kurs përgatit studentët për zbatimin e njohurive dhe praktikave të zhvillimit të fëmijës në identifikimin e vështirësive dhe vonësive zhvillimore dhe ndërhyrjen e hershme. Studentët shkathtësohen të përdorin egzaminimin e lëvizjes/lojës/vizatimeve dhe komunikimeve të fëmijës për identifikimin e zhvillimit tipik apo atipik dhe identifikimin e modeleve të sjelljeve të fëmijëve. Studentët mësojnë për modelet e vlerësimit të zhvillimit që përdoren në mjediset edukative në fëmijëri të hershme, modelet e intervenimit dhe metodat dhe strategjitë e punës që zbatohen në ambientet e natyrshme të fëmijës (familje



dhe mjedis edukativ) për stimulim të zhvillimit dhe modifikim të sjelljes. Studentët shkathtësohen të identifikojnë vështirësitë/pengesat në zhvillim, të identifikojnë origjinën e tyre dhe faktorët ndikues, dhe të dizajnojnë/zbatojnë aktivitete bazike intervenuese me fëmijët.

#### LOJËRAT NË NATYRË

Ky kurs adreson rolin e mjedisit dhe aktiviteteve në natyrë me qëllim të nxitjes së kuriozitetit, kreativitetit, vëzhgimit dhe zhvillimit të mendimit kritik tek fëmijet. Kursi ka për qëllim që studentin ta pajisë me njohuri si të bëj ndërlidhjen e fenomeneve natyrore me konceptet shkencore përmes eksplorimit, lojës, ekzaminimit, vëzhgimit dhe të mësuarit. Në këtë kurs studenti do të fitoj njohuri bashkëkohore mbi natyrën dhe ndërlidhjen e njeriut me natyrën, evolucionin e natyrës dhe pozitën e njeriut në natyrë, vlerat që merr njeriu nga natyra dhe si ndikon në natyrë. Poashtu studenti do të fitoj bazë të njohurive bashkëkohore mbi komponentet përbërëse të natyrës. Duke pas parasysh edhe njohuritë e studentëve të fituara në kurset paraprake, kursi do të fokusohet poashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërlidhjen e mjedisit me dukuritë që ndodhin në natyrë, duke i bërë fëmijët protagonist kryesor të interaksionit (ndërveprimit) me natyrën. protagonist kryesor të interaksionit (ndërveprimit) me natyrë.

#### VLERËSIMI NË FËMIJËRINË E HERSHME

Kursi njofton studentët me teorinë dhe praktikën e vlerësimit të fëmijëve prej lindjes deri në moshën gjashtë vjeçare. Studentët do të mësojnë përse vëzhgimi, vlerësimi dhe dokumentimi janë elemente qenësore të praktikave reflektive. Ata do të studiojnë dhe analizojnë instrumente të ndryshme të vlerësimit të cilat përdoren për të dokumentuar zhvillimin dhe përvojat e të nxëniet të fëmijëve. Vëzhgimet e fëmijëve duke përdorur këto instrumente do të zhvillojnë tek studentët shkathtësi të nevojshme për të vlerësuar nevojat, interesat, dëshirat dhe potencialet e secilit fëmijë duke pasur parasysh ndryshimet individuale dhe kulturore. Pjese e rendesishme e këtij kursi është reflektimi profesional i edukatoreve.

#### EDUKIMI SHËNDETËSOR

Ky modul shqyrton shëndetin dhe përcaktuesit e shëndetit, aspektet rregullative vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme për shëndet, burimet dhe mundësitë për edukim shëndetësor, përgjegjësitë e edukatorëve shëndetësor në mësimin për shëndetin dhe promovimin e shëndetit. Perspektivat kulturore në shëndet dhe sëmundje. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe multidisiplinar në promovim dhe parandalim të sëmundjeve dhe planifikim të aktiviteteve. Mjediset e shëndetshme. Shkollat promovuese të shëndetit. Shkathtësitë komunikuese të aplikuara në edukimin shëndetësor. Vetitë e edukatorit të mirë. Metodot dhe mjetet edukativo shëndetësore. Ndikimi i mediave dhe materialeve audio vizuale.

#### LETËRSI PËR FËMIJË

Programi i lëndës Letërsi për fëmijë si lëndë në nivelin universitar ka për qëllim t'i njohë studentët e programit parashkollor me letërsinë për fëmijë si fushë specifike e letërsisë në përgjithësi, si dhe me autorë e vepra që bëjnë vlerat kulminante të saj. Në këtë mënyrë

studentët do të njihen me llojet letrare për fëmijë dhe do të aftësohen për punë kërkimore shkencore, duke u aftësuar për bartjen e këtyre njohurive të fëmijët, por edhe të mësimdhënësit e ardhshëm, duke aplikuar metodologji, strategji, parime, kritere, tekniqe e forma të punës që lidhen me punën në institucionet parashkollore, para së gjithash, por edhe me mësimdhënien e letrësisë në shkollë.

#### SHKENCAT SHOQËRORE NË FËMIJËRI TË HERSHME

Kursi "Shkencat shoqërore në fëmijëri të hershme" eksploron konceptet dhe teoritë esenciale të shkencave shoqërore dhe mënyrën se si ato zbatohen në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve në fëmijëri të hershme. Ky kurs synon të paraqet elementët socialë, kulturorë dhe psikologjikë që ndikojnë në përvojat e hershme të një fëmije dhe se si fëmijët e vegjël e shohin botën, lidhen me të tjerët dhe e shohin veten në mjedisin ku jetojnë. Kursi synon t'u sigurojë mësimdhënësve metoda dhe mjete për të ndihmuar të mësuarit socio-emocional, ndërjegjësimin kulturor dhe zhvillimin social në mjediset e fëmijërisë së hershme, me theks në teknikat e përshtatshme për moshën. Ndërveprimet sociale, zhvillimi i identitetit, diversiteti, strukturat familjare dhe ndikimet e komunitetit janë disa nga temat që shqyrtohen në këtë kurs.

#### METODOLOGJIA MONTESORI

Ky kurs ka për synim të njoftoj studentët me filozofinë e metodologjisë Montessori duke u fokusuar tek mosha e fëmijërisë së hershme (0 deri 6 vjeç). Studentët do të aftësohen që përmes kësaj metodologjie të përkrahin zhvillimin e fëmijëve përmes praktikave sensorike. Metodologjia Montessori përgatitë studentët të zbatojnë çasjen bashkëkohore të edukimit me theks në rëndësinë e kulturës dhe pa paragjykime. Studentët do të analizojnë ambientin, mjetet, materialet dhe sjelljet e edukatorëve që mbështesin metodologjinë Montessori. Në këtë lëndë studentët do të praktikojnë në laboratorin Montessori në Fakultetin e Edukimit teknika të punës me fëmijë duke aplikuar teorinë në praktikë. Studentët gjithashtu, do të jenë në gjendje të organizojnë ambientin dhe mjetet bazuar në standarde të metodologjisë.

#### ZHVILLIMI SOCIO-EMOCIONAL

Ky kurs është dizajnuar në atë mënyrë që të adresojë të kuptuarit e nocioneve të ndjenjave dhe emocioneve, reagimeve afektive të fëmijës, perspektivat teorike të zhvillimit socio-emocional, faktorët që ndikojnë zhvillimin e dimensionit socio-emocional si dhe relevancën e këtij dimensionit në periudhën e fëmijërisë së hershme dhe moshën parashkollore. Poashtu, kursi adreson dhe rëndësinë e ndërveprimeve të para sociale dhe emocionale të fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton; kompleksitetin e zhvillimit socio-emocional dhe ndikimin e faktoreve kryesorë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Përmbajtja e kursit vë theksin tek shprehja e emocioneve si forme e parë e komunikimit në fëmijërinë e hershme dhe moshën parashkollore, që njihet si komunikim emocional. Kursi ofron të dhëna të përgjithshme dhe specifike lidhur me aftësimin e studentëve (si edukatorë të ardhshëm) për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin emocional dhe social; mënyrat se si zhvillohen fëmijët në aspektin socio-emocional; si fëmija i shfaqë dhe identifikon emocionet; si zhvillohen ato; si menaxhohen dhe perdoren emocionet për të ndihmuar ndërveprimin dhe zhvillimin e fëmijëve; si zhvillon kompetencat socio-

emocionale fëmiu përmes përkrahjes së dimensionit socio – emocional; sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijut që nga foshnjëria e tutje, si bazë për fazat e tjera të zhvillimit; si dhe identifikimi, kujdesi dhe adresimi i vështirësive emocionale dhe sociale përgjatë zhvillimit të tyre

#### EDUKIMI PËRMES STEM

Ky kurs është dizajnuar për edukatorët në fëmijëri të hershme dhe ka për qëllim të shqyrtojë shumë aktivitete që ato duhet të realizojnë me fëmijët për të mbështetur mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve në STEAM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë). Kursi do të shtjellojë rendësin e jashtëzakonshme të përvojës që fëmijët kanë gjatë viteve të hershme të jetës së tyre. Edukatorët do të mësojnë se fëmijët janë kureshtarë për nga natyra dhe se fëmijët duke luajtur, duke eksploruar dhe duke parashtruar shumë pyetje - mësojnë për veten, për të tjerët dhe për botën rreth tyre. Duke prezantuar STEAM përmes lojës edukatorët do të ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë një numër të madh të shkathtësive si p.sh. të bëjnë pyetje, të punojnë së bashku, të mendojnë në mënyrë kritike, të zgjedhin probleme, të testojnë probleme, e të zbulojnë mënyra alternative për të bërë gjërat. Me fjalë të tjera ky kurs ofron mundësinë që edukatorët të zhvillojnë aftësinë e inkurajimit të fëmijëve që të bëjnë pyetje dhe të marrin një rol aktiv në të mësuarit e tyre dhe të kuptojnë botën rreth tyre.

#### EDUKIMI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Zhvillimi i qëndrueshëm është korniza e politikbërjes globale sot, dhe pjesë integrale e kurrikulave nacionale në shumicën e vendeve të botës. Në Kosovë, edukimi për zhvillim të qëndrueshëm është pjesë e Kurrikulës Kurrikulare si çështje ndërkurrikulare që nga viti 2016. Studenti-mësimdhënës për edukatorë në fëmijërinë e hershme me këtë kurs do të pajiset me njohuri shkencore mbi konceptet themelore mjedisore dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, raportin e njeriut me mjedisin jetësor dhe zhvillimin socio-ekonomik si dhe rolin e edukimit të gjeneratave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm.

#### LOJËRAT MUZIKORE

Kursi ofron metoda dhe strategji të mësimdhënies së muzikës të cilat kontribuojnë në realizimin e komponenteve të edukimit muzikor që parashihen në programin mësimor (kurrikulën e edukimit parashkollor dhe standardet e zhvillimit në fëmijërinë e hershme). Në këtë kurs studentët do të diskutojnë për aspektet teorike dhe metodat e mësimdhënies së muzikës përmes lojërave muzikore në nivelin parashkollor 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç. Studentët gjithashtu do të realizojnë në mënyrë praktike lojërat të ndryshme muzikore (lojërat ritmike, lojëra kreative muzikore, lojërat didaktike muzikore etj.).

#### STANDARDET DHE KOMPETENCAT PROFESIONALE

Kursi ka një kohëzgjatje prej 15 javësh dhe është projektuar për të siguruar studentëve në zhvillim për përgaditje profesionale, njohuri të përmblëdhura për standartet profesionale dhe kompetencat themelore për edukim cilësor në ambientet e edukimit të fëmijërisë së hershme. Pjesëmarrësit do të shqyrtojnë bazat teorike, parimet etike dhe aplikimet praktike të standarteve profesionale në fushën e edukimit në fëmijëri të hershme. Më konkretisht pra pjesëmarrësit do të njohin teorinë më të njohura për edukimin në fëmijërinë e hershme,

të analizojnë standartet profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare në edukimin në fëmijëri dhe hershme ; të shqyrtojnë parimet etike dhe përgjegjësitë lidhur me edukimin në fëmijëri dhe hershme:të promovojnë praktikën reflektuese për vlerat vetjake në lidhje me standartet profesionale dhe zhvillimin profesional.

#### MENAXHIMI I KLASËS

Menaxhimi i klasës në edukimin e fëmijërisë së hershme është thelbësor për krijimin e një mjedisi mësimor pozitiv dhe produktiv. Strategjitë efektive të menaxhimit të klasës i ndihmojnë edukatorët të vendosin rutina, të nxisin ndjenjën e komunitetit dhe të mbështesin zhvillimin tërësor të fëmijëve. Gjithashtu, përmes këtij kursi elaborohet edhe komponenta e krijimit të një ambienti fizik dhe emocional i cili është ftues, nxitës dhe i bën ata të ndihem mirë përmes përjetimit të barazisë, rregullit, drejtësisë dhe në të njëjtën kohë menaxhimit të sjelljes dhe vetëkontrollit.

#### DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA

Ky kurs synon të zhvillojë teorikisht dhe praktikisht njohuritë lidhur me konceptet kryesore të tekstit të dramaturgjisë, përrallave apo tregimeve të cilat inskenohen në teatër. Kursi vë theksin më shumë te komunikimi me fëmijët dhe përvetësimi i shkathtësive të nevojshme në edukim. Loja e aktorit me kukullën.

#### PUNË DORE ME MODELIM

Studentët njihen me materialet e ndryshme në natyrë dhe mjedisin jetësor në fëmijëri të hershme. Mësohen dhe zhvillojnë idetë kreative, dizajnojnë, modelojnë me të gjitha llojet e materialeve përmes të cilave realizohen projekte me motive të ndryshme si: letra, druri, tekstilet, artikujtë ushqimor, argjila, gipsi, sapunet, plastelina, etj. Studentët e edukimit në fëmijëri të hershme njihen dhe zhvillojnë edukatën e ndërmarrësisë në jetë dhe hartojnë nje plani të Bisnesit (ndërmarrësisë).

#### ZHVILLIMI KOGNITIV

Lënda mundëson që studentët të përvetësojnë konceptet, përmbajtjet dhe teorinë bazë që lidhen me njohjen dhe zhvillimin e njohjes (kognicionit) tek fëmijët që nga mosha e hershme - menjëherë pas lindjes. Do të kenë mundësinë e njohjes me perspektivat në fushën e psikologjisë kognitive dhe zhvillimit të fëmijëve në vend dhe më gjerë, dhe të kuptojnë psikologjinë kognitive si studim i rrugëve dhe përpjekjeve për zhvillimin e të menduarit në përgjithësi.

#### METODOLOGJIA REXHIO EMILIA

Ky kurs ka për qëllim që të aftësojë studentët për punë sipas metodologjisë Rexhio Emilia, kursi avancon tutje njohuritë teorike të studentëve mbi filozofinë Rexhio Emilia dhe shkathtëson ata në përdorimin praktik të kësaj metodologjie duke ndihmuar përmes aplikimit të aktiviteteve praktike sipas kësaj metodologjie për grup moshat lindje -3 vjeç dhe 3-6 vjeç. Studentët do të analizojnë ambientin, mjetet, materialet, rolin e edukatorit, rolin e atelies dhe miniatelies, rolin e artistit, dokumentimit të punës së fëmijëve, bashkëpunimit dhe prindër dhe të tjera elementeve përbërëse të kësaj metodologjie.

Studentët do të praktikohen në ndërtimin e projekteve edukative sipas qasjes reXHiane dhe të kuptuarit e filozofisë së punës me fëmijën në qendër sipas konceptit reXHian.

#### RUTINAT MATEMATIKORE

Ky kurs i trajton rutinat si të lojëro, përcakton rutinat, dhjetë-kornizat, idetë matematikore, modelet matematikore, rutinën me brezin aritmetik dhe renditjen e numrave.

#### KUJDESI DHE TË USHQYERIT PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Edukatorët e fëmijërisë së hershme luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e kujdesit, mirëqenies dhe ushqyerjes së fëmijëve qysh në moshat më të hershme. Krijimi i një ambient të sigurtë, menagjimi i reziqeve për mirëqenien e fëmijëve, promovimi i shëndetit të mirë dhe ushqyerjes së mirë jo vetëm në përmbajtje por edhe si proces, janë pjesë kryesore e këtij kursi. Qëllimi i këtij kursi është që tek edukatorët e rinjë të zhvillojë të kuptuarit mbi rëndësinë e krijimit të një ambient të sigurtë përmes një qasje holistike, të promovojë shëndetin e mirë dhe të zbatojnë praktika positive në procesin e ushqyerjes së mirë në moshë të hershme. Për më tepër edukatorët e rinjë do të përgatiten që kjo qasje të integrohet në kurrikulë edhe si mjet edukimi i fëmijëve dhe prindërve të tyre.

#### UDHËHEQJA E INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE

Lënda do t'iu mundësojë studentëve të kuptojnë konceptet e menaxhimit, dhe të njihen me metoda bashkëkohore të menaxhimit të institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme. Do të eksplorojnë disa nga përgjegjësitë kryesore të udhëheqësve të institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme, sic janë përgatitja dhe menaxhimi i planit zhvillimor të institucionit të edukimit në fëmijërinë e hershme, mbështetja dhe mbikqyrja e zbatimit të kurikulës, mbështetja dhe zhvillimi profesional i mësimitdhënësve, sigurimi i një ambienti të sigurtë për mësimitdhënie dhe nxënie, si dhe ndërveprimi dhe komunikimi me akterët e jashtëm.

#### BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM

Ky kurs fokusohet në paradigmat, çështjet dhe metodat e hulumtimeve në edukim. Temat që përfshihen në këtë kurs janë: përkufizimi i metodave të ndryshme të hulumtimeve, analiza kritike e literaturës, grumbullimi i të dhënave sasiore dhe atyre cilësore nga mjediset e të nxënit, natyra dhe llojet themelore të hulumtimeve, të lexuarit kritik dhe interpretimi i hulumtimeve, Studentët do të bëhen "lexues kritik" në mënyrë që të analizojnë hulumtimet sasiore dhe cilësore në fushën e edukimit dhe të shfrytëzojnë rezultatet kërkimore në realizimin e hulumtimeve të tyre për përmirësimin e praktikave të mësimitdhënies dhe të nxënit.

#### PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV

Përmes praktikës pedagogjike IV studentet do të kenë mundësi të fillojnë zbatimin praktik të dijeve të fituara gjatë kurseve të zhvilluara për katër vitet e studimit. Përmes Doracakut të Mësimit Praktik studentët do të njihen me përgjegjësit dhe detyrat e tyre gjatë praktikës pedagogjike. Praktika pedagogjike organizohet fillimisht në fakultet përmes fondit të paraparë të orëve dhe pas përgatitjeve të nevojshme studentët në varësi të prireve dhe

nevojave që ata kanë mund të zgjedhin edhe grupin edukativ në të cilin ata kanë dëshirë apo nevojë të shkojnë. Gjatë "Praktikës pedagogjike IV" studentët të pritët të fitojnë eksperiencë për të punuar në të gjitha grupet edukative sipas të gjitha grupmoshave. Studentët do të qëndrojnë në kopsht/shkollë për 8 javë rresht (4 javë tek grup-moshat deri në 3 vjeç dhe 4 javë tjera tek grupmosha 3-6 vjeç) duke marrur përsipër aktivitete përgatitore dhe të punës së drejtëpërdrejtë me fëmijë, nën mentorimin e edukatores mentore. Në anën tjetër, studentët do të reflektojnë në mënyrë kritike për vëzhgimet e tyre, në ditarin personal të praktikës pedagogjike dhe do të përgatisin porfolion për të dokumentuar angazhimin e tyre në praktike. Përfundon projektin përfundimtar ashtu siç është dakorduar me profesorin.

#### PUNIMI I DIPLOMËS

Tema e diplomës përfaqëson një projekt tipik kërkimor që studentët duhet të kryejnë si pjesë e studimeve të tyre universitare. Qëllimi i punimit të diplomës është t'u ofrojë studentëve një mundësi për të eksploruar në mënyrë të pavarur një temë specifike brenda fushës së tyre të studimit dhe të demonstrojnë të kuptuarit e tyre për lëndën. Ajo i lejon studentët të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që kanë fituar gjatë studimeve të tyre universitare për një pyetje apo problem të veçantë kërkimor. Tema e diplomës mbikëqyret nga një mentor i zgjedhur nga secili student që përfaqëson fushën specifike të edukimit që është në interes të studentëve. Punimet e diplomës përgatiten duke punuar në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor dhe në bazë të Manualit të Temave të Diplomës për nivelin BA. Zakonisht studentët e harmonizojnë procesin e tyre kërkimor me praktikën e mësimdhënies e cila bëhet në semestrin e tyre të fundit, ndërkohë që ata ndjekin edhe kursin për kërkimin arsimor. Eduktori i si hulumtues është një nga qëllimet kryesore të programit në përgjithësi dhe tema e diplomës përfaqëson mundësinë për të treguar se si është zhvilluar kjo aftësi gjatë programit.